21.12.20
SKPMSHCK 3253/2020 117

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.359/2020**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj - anëtare, dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.359/2020 të datës 13.11.2020 të parashtruar nga ankuesit: [redacted] të cilët me autorizim i përfaqëson ankuesi [redacted] me adresë Rruga "Adem Jashari", Nr.2, ndërtesa e Komunës, në Komunën e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.12.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankueseve: [redacted].

[redacted], Merita [redacted] e parashtruar me ankesën me numër A.nr.359/2020, të datës 13.11.2020 nga përfaqësuesi i autorizuar [redacted].

**II.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **Shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesat e ankuesve [redacted] dhe [redacted] të parashtruara me ankesën me numër A.nr.359/2020, të datës 13.11.2020, nga përfaqësuesi i autorizuar [redacted]

**Arsyetim**

Ankuesit [redacted], Fadil [redacted], Ardiana [redacted] të cilët i përfaqëson ankuesi i autorizuar [redacted], janë nëpunës të Komunës së Obiliqit.

Komuna e Obiliqit duke u mbështetur në nenin 22 paragrafin 2.3 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë Nr.03/L-147 si dhe në nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të gjithë ankuesve iu ka njohur të drejtës e një page jubilare prej 25% të pagës mesatare në shërbimin civil.

Ankuesit [redacted] Bajrami, [redacted] të cilët i përfaqëson ankuesi i autorizuar [redacted], bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe

Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.11.2020 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 2590/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 26.11.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Komunën e Obiliqit. Më datë 04.12.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Obiliqit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova**: Ankesën me numër protokolli 2590/2020 të datës 13.11.2020 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Nënshkrimi i zyrtarëve të administratës së Komunës së Obiliqit për ankesë në KPMSHCK; Kopja e letërnjoftimit e përfaqësuesit të ankuesve Z. [redacted] Vendimi Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1253, i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1256 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i ankueses [redacted] i datës 01.01.2013; Vendimi Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1257 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1258 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 01.04.2011; Vendimi Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1259/ i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted]; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1261 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit 11-1262 i datës 27.11.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1263 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1264 i datës 27.10.2020 si dhe plotësim ndryshimi i akt emërimit i znj. Drita Behrami i datës 15.06.2015; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1265 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] i datës 27.03.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1266 i datës 27.10.2020 si dhe ndryshim plotësimi i akt emërimit i z. [redacted] i datës 20.02.2014; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1267 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1268 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1269 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. Sala Paci; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1270 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1271 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.05.2018; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1274 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1275 i datës 27.10.2020; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1277 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1280 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1281 i datës 27.10.2020 si dhe vendimi i datës 14.09.2017 i znj. [redacted] si dhe akt emërimi i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1282 i datës 27.10.2020 si dhe ndryshim plotësimi i akt emërimit

për nëpunësin civil Naim Cerkezi i datës 20.05.2019; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1283 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] i datës 01.04.2011; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1285 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj.[redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit 11-1288 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 01.04.2011; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1290 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z.[redacted] i datës 01.07.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1317 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 11.04.2014; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1291 i datës 27.10.2020 si dhe kontrata e punës për nëpunësin [redacted] e datës 01.10.2015; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1293 i datës 27.10.2020; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1296 i datës 27.10.2020 si dhe vendimi për sistemim i z. [redacted] i datës 29.01.2018; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1297 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj[redacted] datës 03.02.2014; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr. 11-1299 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1300 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1301 i datës 27.10.2020 si dhe ndryshim plotësimi i akt emërimit i datës 20.02.2014; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1303 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] i datës 01.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1304 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z.[redacted] Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1306 i datës 27.10.2020 si dhe plotësim ndryshimi i akt emërimit i z.[redacted] Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1307 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted]; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1308 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj.[redacted] i datës 03.09.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1309 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 19.02.2014; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1311 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj.[redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1312 i datës 27.10.2020; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1315 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z.[redacted] i datës 24.01.2014; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1318 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1319 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] datës 01.04.2011; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1320 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj [redacted] i datës 01.08.2014; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1321 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 01.08.2016; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1322 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1323 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj.[redacted]; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1326 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1335 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj.[redacted] Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1342 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z.[redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1325 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1327 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj.[redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-

1328 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1329 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] i datës 01.01.2011; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1330 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1331 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.01.2013; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1336 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.02.2014; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1337 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i znj. [redacted] i datës 02.11.2015; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1338 i datës 27.10.2020; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1304 i datës 27.10.2020; Marrëveshja e përgjithshme kolektive e Kosovës; Kërkesa për përgjigje e datës 26.11.2020; Përgjigja në kërkesë e datës 04.12.2020; Lista e nëpunësve përfitues të pagës jubilare; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Obiliqit Nr.11-1393 i datës 27.10.2020 si dhe akt emërimi i z. [redacted] i datës 03.01.2013; si dhe prova shtesë- emali zyrtar i datës 15.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve [redacted] dhe [redacted], është e pa bazuar, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve të cilët pretendojnë që e drejta në shpërblimin jubilar të realizohet në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës si dhe kundër vendimeve për pagesën e shpërblimit jubilar dhe për mos pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesit [redacted]

[redacted] dhe [redacted] janë nëpunës civil të punësuar në administratën e Komunës së Obiliqit dhe se statusi i nëpunësve civilë rregullohet me Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa lidhur me pagesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesve të cilët pretendojnë që e drejta në shpërblimin jubilar të realizohet në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka konstatuar që ankuesit kanë statusin e nëpunësve civil dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet rrjedhin nga Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, po ashtu edhe kompensimet e nëpunësive civil janë të parapara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji, në këtë rast edhe mënyra e kompensimit me rastin e shpërblimit jubilar bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 21 paragrafit të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë e cila përcakton që: *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune"*, rrjedhimisht nga kjo ankuesit nuk ju takon kompensimi siç përcaktohet me Kontratën e Përgjithshme Kolektive sepse kontrata e lartcekur nuk është ne fuqi dhe se e njëjta nuk është rinovuar nga anëtarët e Këshillit Ekonomiko Social.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Obiliqit me datë 27.10.2020 ka nxjerr vendime për pagesën e pagave jubilare për ankuesit [redacted] dhe [redacted] duke vepruar kështu në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë për të gjithë ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesve për mos pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi me datë 14.12.2020 përmes emalit zyrtar ka kërkuar nga Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Obiliqit që ta informoj Këshillin *"se a është pensionuar ndonjëri nga ankuesit të cilët*

*janë pjesë e ankesës"*. Këshilli përmes emalit zyrtar të datës 15.12.2020 ka pranuar përgjigjen nga Udhëheqësja e Personelit e Komunës së Obiliqit e cila ka theksuar se: *"... Ju njoftojmë se në listën e ankuesve që kanë paraqitur ankesë nuk ka zyrtar që janë të pensionuar"*, rrjedhimisht nga kjo Kolegji konstaton se asnjë nga ankuesit nuk e ka arritur moshën e pensionimit në shërbimin civil dhe se në rastin konkret nuk kemi shkelje të të drejtave të ankuesve, dhe se Kolegji nuk mund që të vendos për raste hipotetike të cilat nuk kanë ndodhur, apo që priten të ndodhin në të ardhmen.

Ndërsa sa i përket ankesave të ankuesve [redacted] dhe [redacted], Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave te bashkangjitura ne dosjen e lëndës, konstatoi se lidhur me ankesat e tyre Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *është jo kompetent* për të vendosur, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar provave të lëndës respektivisht kontratës së punës të datës 01.10.2015 të ankuesit [redacted] konstatohet se i njëjti mban pozitë "Nëpunës për preventiv kundër zjarrit", kontrata që është lidhur duke u mbështetur në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, ndërsa në bazë të provave të lëndës ankuesi [redacted] në bazë të vendimit të datës 29.01.2018 mbanë pozitën "Roje Pylli", si rrjedhojë pozitat e ankuesve të lartcekur janë të përjashtuara nga shërbimi civil në bazë të nenit 2 paragrafit 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: ***"Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike"***.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**
**Lënda me numër A.nr.359/2020**

*Hysni Mustafa* — *Procesmbajtës*

*Malsore Gashi Bajraktari* — *Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet:**

- *Përfaqësuesit të ankuesve z.* [redacted]
- *Kryetarit të Komunës së Obiliqit;*
- *Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Obiliqit dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*